



Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

## **RELACION**

### **PËR**

### **PROJEKTVENDIMIN**

## **MBI PËRDORIMIN NË PROCESIN ZGJEDHOR TË DISA MATERIALEVE DHE PËRCAKTIMIN E KARAKTERISTIKAVE TË PËRGJITHSHME TË TYRE NË PËRDORIM PËR PROCESIN E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT**

### **I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2 të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ – së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë tjetër që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit os KAS-it.

Neni 24 pika 1 parashikon kompetencen e KQZ-së lidhur me votimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Aty parashikohet se KQZ-ja drejton, mbikëqyr dhe është përgjegjëse për procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave, që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin.

Neni 25 parashikon mënyrën e votimi të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, administrimin e materialit zgjedhor të nisur nga këta zgjedhës si dhe nxjerrjen e rezultatit zgjedhor.

Neni 99 e vijues i Kodit Zgjedhor parashikon rregullat lidhur me dërgimin e materialeve zgjedhore nga KQZ-ja, duke listuar të gjithë materialet zgjedhore që dërgohen dhe përdoren nga KQV-të deri në nxjerrjen e rezultatit zgjedhor, pjesë të të cilave janë edhe materialet e parashikuara në lidhjen 1 të këtij vendimi.

Vendimi nr. 13, datë 12.11.2024 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, në kreun III (konkretisht nënkreu III.I) me titull “Rregulla të posaçme” parashikohet dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë vendit, që janë: fleta e votimit, zarfi ku futet fleta e votimit, materiali udhëzues që përmban sqarime për zgjedhësin për plotësimin e fletës së votimit, për procedurat e dërgimit mbrapsht të fletës së votimit nga zgjedhësi në KQZ, zarfi i jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim përcaktimin e rregullave për përdorimin e disa materialeve, si dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit.

Në Aneksin 1 bashkëlidhur këtij projektakti renditen materialet zgjedhore, përdorueshmëria e tyre, si dhe karakteristikat e përgjithshme dhe të veçanta të tyre.

- Projekt akti liston si material zgjedhor vulat me kod sigurie, të cilat shërbejnë për vulosjen e të gjitha kutive të votimit nga jashtë dhe të materialeve zgjedhore përgjatë procesit zgjedhor dhe verifikimit paszgjedhor për të garantuar integritetin e fletëve të votimit nga jashtë dhe dokumentacionit zgjedhor.

Vulat me Kod Sigurie si karakteristika të përgjithshme kanë rezistencën, janë të testuara për një forcë thyerje, tërheqje, përkulje dhe të jenë sipas standardeve të zbatueshme.

- Në projekt akt listohen si material zgjedhor, kutitë e votimit, të cilat do të përdoren për të mundësuar depozitimin e dokumentacionit zgjedhor të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në procesin zgjedhor, veçmas për çdo qark. Kutitë e votimit ku do të hidhen materiali zgjedhor i zgjedhësve nga jashtë vendit janë të njëjta por në varësi të përdorimit kryejnë 4 funksionalitete:
  - Kuti të votimit
  - Kuti rezervë të votimit
  - Kuti e posaçme e votimit
  - Kuti rezervë e posaçme e votimit

Kutitë e votimit nga jashtë si karakteristikë të përgjithshme duhet të jenë të palosshme, të hapura vetëm nga një anë, në të cilën vendoset kapaku përkatës dhe nëpërmjet të cilit mundësohet hedhja e dokumentacionit zgjedhor, duhet të jenë të tejdukshme nga të paktën katër anët e saj, të kenë aftësi për të mbajtur ngarkesa të brendshme pa u deformuar. Pjesa e sipërme e kutive (kapaku) të jetë e qëndrueshme ndaj presionit të jashtëm. Kutitë e votimit nga jashtë duhet të mbyllën me kapak i cili lidhet me kutinë me 4 vula me kode sigurie. Kapaku duhet të ketë një të çarë nëpërmjet të cilës mund të futet dokumentacioni zgjedhor i ardhur nga jashtë, por njëkohësisht kjo e çarë nuk duhet të lejojë nxjerrjen e dokumentacionit. E çara duhet të mundësojë funksionalitetin e mbylljes me vulë me kod sigurie.

Si karakteristika të veçanta për kutitë e votimit nga jashtë përcaktohen: kapaciteti mbajtës i kutive të votimit nga jashtë duhet të jetë të paktën 100 litra, afërsisht e barabartë me kapacitetin e 1.000 dokumentacioneve me përmasa (A3), të palosura dhe të jenë me transparencë të lartë për të vëzhguar lehtësisht mos tjetërsueshmërinë e votës. Forma e e kutive duhet të jetë prizëm gjysmë piramide me lartësi të brendshme 60 cm (+/- 2). Kapaku i kutive të votimit nga jashtë duhet të ketë hapësirën e posaçme ku futet dokumentacioni zgjedhor nga jashtë, të ketë dimensione që përputhen me kutitë e votimit nga jashtë dhe të mbyllet pa krijuar hapësira me buzët e kutive të votimit nga jashtë. Pjesa e hapur e kapakut nëpërmjet të cilës hidhet dokumentacioni zgjedhor të mbyllet me të paktën një vulë sigurie në përfundim të procesit të votimit.

- Në projekt akt renditet si material zgjedhor edhe Etiketat e Sigurisë, e cila shërben për vulosjen/matrikulimin e materialeve/ambienteve të ndryshme zgjedhore gjatë gjithë proceseve të punës.

Etiketat e sigurisë si karakteristikë të përgjithshme duhet të kenë të gjithë elementët e sigurisë për të mbrojtur sendet/asetet/ ambientet nga çdo ndërhyrje e personave të tjerë, të jetë e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse, si dhe të ketë veti gjurmëlënëse të dallueshme që lë etiketa në trupin e saj ose në sipërfaqen e rrafshët ku do të vendosen. Etiketat e sigurisë janë projektuar për një përdorim dhe nuk hapen aksidentalisht.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, *“Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”*.

**Jona JOSIFI - Drejtorja e Votimit nga Jashtë**

**Pavlina DOÇAJ – Drejtorja e Ligjshmërisë**

**Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data

Nr:

Ora:

**VENDIM**

**MBI**

**PËRDORIMIN NË PROCESIN ZGJEDHOR TË DISA MATERIALEVE DHE**  
**PËRCAKTIMIN E KARAKTERISTIKAVE TË PËRGJITHSHME TË TYRE NË**  
**PËRDORIM PËR PROCESIN E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 24 pika 1, nenit 25/1 dhe të nenit 99 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr.13, datë 12.11.2024 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**VENDOS:**

1. Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor për votimin nga jashtë vendit, të përdoren kutitë e votimit nga jashtë si dhe materialet e tjera të përshkruara në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përcaktimi i sasive të kutive të votimit nga jashtë apo materialeve të tjera, si dhe i kriterëve dhe specifikimeve teknike, veçmas atyre që përmban lidhja 1, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
3. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data:

Nr:  
Ora:



“Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”

## Lidhja 1

Materiali zgjedhor	Përdorueshmëria	Karakteristika të përgjithshme	Karakteristika të veçanta
<p><b>1.Vulat me Kod sigurie</b></p>	<p>Shërbejnë për vulosjen e të gjitha kutive të votimit nga jashtë dhe të materialeve zgjedhore përgjatë procesit zgjedhor dhe verifikimit pas zgjedhor për të garantuar integritetin e fletëve të votimit nga jashtë dhe të dokumentacionit zgjedhor.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Vula e sigurisë duhet të jetë rezistente dhe e testuar për një forcë thyerje, tërheqje, përkulje dhe të jetë sipas standardeve të zbatueshme.</li> <li>2.Vula është e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse.</li> <li>3.Vula duhet të jetë e projektuar për një përdorim dhe nuk hapet aksidentalisht.</li> <li>4.Çdo përpjekje për të ndërhyrë me anë të ushtrimit të nxehtësisë, forcës mekanike (duke futur një mjet, duke e shpuar, përkulur apo tërhequr) apo kimikateve (tretësve) është e dallueshme nëpërmjet shenjave që lë.</li> <li>5.Ajo duhet të jetë rezistente ndaj agjenteve atmosferik dhe fizik.</li> <li>6.Ngjyra përcaktohet në varësi të procesit zgjedhor dhe procesit të punës (ngjyrë të veçantë për vulat që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit nga jashtë dhe ngjyrë të</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vula e sigurisë do të jetë me qëndrueshmëri këputjeje për të garantuar paprekshmërinë/ mos hapjen aksidentale në çfarëdo formë të kutive të votimit nga jashtë.</li> <li>2. Përbërësit e ndryshëm të vulës nuk plasariten, nuk deformohen apo nuk çngjyrosen për shkak të ndryshimeve atmosferike.</li> <li>3. Vula duhet të ketë të shënuar këta elementë: Emri i institucionit: “KQZ”. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri serial i vulës i cili është unik, nga 6 deri në 8 shifra.</li> <li>• Barcodi linear / QR code duhet të jetë dhe i qëndrueshëm në trupin e vulës duke siguruar mos fshirjen e tij nëpërmjet fërkimit apo formave të ngjashme</li> </ul> </li> <li>4. Numri i shifrave të variojë sipas konsumit, shifrat nuk duhet të jenë të përsëritshme duke përfshirë edhe ato të përdorura më parë.</li> </ol>



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

		ndryshme për vulat rezervë).	
<b>2. Kutitë e votimit</b>	<p>Kutitë e votimit nga jashtë do të përdoret për të mundësuar depozitimin e dokumentacionit zgjedhor të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në procesin zgjedhor, veçmas për çdo qark.</p> <p>Kutitë e votimit nga jashtë janë 4 lloje:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Kuti të votimit nga jashtë;</li><li>2. Kuti rezervë të votimit nga jashtë;</li><li>3. Kuti e posaçme e votimit nga jashtë;</li><li>4. Kuti rezervë e posaçme e votimit nga jashtë.</li></ol>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Kutitë e votimit nga jashtë të jenë të palosshme, të hapura vetëm nga një anë, në të cilën vendoset kapaku përkatës dhe nëpërmjet të cilit mundësohet hedhja e dokumentacionit zgjedhor.</li><li>2. Kutitë e votimit nga jashtë janë të tejdukshme nga të paktën katër anët e saj.</li><li>3. Kutitë e votimit nga jashtë duhet të kenë aftësi për të mbajtur ngarkesa të brendshme pa u deformuar.</li><li>4. Pjesa e sipërme e kutive (kapaku) të jetë e qëndrueshme ndaj presionit të jashtëm.</li><li>5. Këto kuti duhet të mbyllet me kapak i cili lidhet me kutinë me 4 vula me kode sigurie.</li><li>6. Kapaku duhet të ketë një të çarë nëpërmjet të cilës të mund të futet dokumentacioni zgjedhor i ardhur nga jashtë, por njëkohësisht kjo e çarë nuk duhet të</li></ol>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Kapaciteti mbajtës (volumi) i kutive të votimit nga jashtë të jetë të paktën 100 litra., afërsisht e barabartë me kapacitetin e 1.000 dokumentacioneve (me përmasa A3) të palosura dhe të jetë me transparencë të lartë për të vëzhguar lehtësisht mos tjetërsueshërinë e votës.</li><li>2. Forma e kutive të votimit nga jashtë të jetë prizëm gjysmë piramide me lartësi të brendshme 60 cm (+/-2 ) cm.</li><li>3. Kapaku i kutive të votimit nga jashtë:<ul style="list-style-type: none"><li>• të ketë hapësirën e posaçme ku futet dokumentacioni zgjedhor nga jashtë,</li><li>• të ketë dimensione që përputhen me kutitë e votimit nga jashtë, dhe</li><li>• të mbyllet pa krijuar hapësira me buzët e kutive të votimit nga jashtë.</li></ul></li></ol>

Data:

Nr:  
Ora:



“Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”

		<p>lejojë nxjerrjen e këtij dokumentacioni.</p> <p>7. E çara në kapakun e kutive të votimit nga jashtë duhet të mundësojë funksionalitetin e mbylljes me vulë me kod sigurie.</p>	<p>4. Pjesa e hapur e kapakut nëpërmjet të cilës hidhet dokumentacioni zgjedhor të mbyllet të paktën me një vulë sigurie në përfundim të procesit të votimit.</p>
<p><b>3. Etiketa e sigurisë</b></p>	<p>Etiketa e sigurisë shërben përvulosjen/ matrikullimin e materialeve/ambienteve të ndryshme zgjedhore gjatë gjithë proceseve të punës.</p>	<p>1. Etiketa e sigurisë duhet të ketë të gjithë elementët e sigurisë për të mbrojtur sendet/asetet/ ambientet nga çdo ndërhyrje e personave të tjerë.</p> <p>2. Etiketa e sigurisë është e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse. Ajo është projektuar për një përdorim dhe nuk hapet aksidentalisht.</p> <p>3. Etiketa të ketë veti gjurmlënëse të dallueshme që lë etiketa në trupin e saj ose në sipërfaqen e rrafshët ku do të vendoset.</p>	<p>1. Trupi i etiketës duhet të jetë i përberë nga material letër plastike (polietilen) me një shtrese dhe i personalizuar me logon e KQZ-së dhe të ketë numër serial unik me 6- 8 shifra.</p> <p>2. Trupi i etiketës së sigurisë të bëjë të mundur etiketimin e të dhënave, si: të përmbajnë fjalën “KQZ” dhe kodin e sigurisë me numër rendor 6-8 shifror.</p> <p>3. Numri i shifrave të variojë sipas konsumit, shifrat nuk duhet të jenë të përsëritshme duke përfshirë edhe ato të përdorura më parë.</p> <p>4. Gjithashtu trupi i etiketës duhet të ofrojë mundësinë e vendosjes të opsionit “Barcode” për aplikacione të lëvizshme.</p>